



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2021

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2020

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158, të Kushtetutës dhe të nenit 63, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit

Miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2020, sipas dokumenteve të mëposhtme, pjesë përbërëse të tij, si më poshtë vijon:

- a) Pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, për vitin 2020;
- b) Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2020, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) Raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2020;
- ç) Raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës, për vitin 2020;
- d) Raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2020.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R

GRAMOZ RUÇI